

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

814-32

M 59

Bahri Myftari


Urbani  
i së hënës

tregime

8JH-32

M 99

Bahri Myftari



Urbani  
i së hënës

---

tregime

Shtëpia Botuese «Naim Frashëri»

## DY SHOKËT

Qershia e Ngjeli Saros piquet ndër të parat në qytet. Këtë «privilegj» Ngjeli e shpjegon vetë: «Kjo qersh, — thotë ai, — e pret e para diellin dhe e përcjell e fundit» Një mëngjes, kur kuqëlimi i kokrrave ende ishte i spërkatur nga vesa, ai e voli qershinë.

— «Një shportë, — tha ai, — do t'ia çoj Lal Likos». Ashtu bëri. Ishte e pamundur që të bënte ndryshe. Ta hante qershinë Ngjeli Saroja dhe të mos hante Lal Likoja?!

Kështu ishte për ata të dy: gëzimi i njërit, sado i vogël apo i madh që të ishte, ishte edhe për tjetrin. Siç i kalonin gëzimet bashkë, ashtu i hidhnin edhe hallet. S'mbahaj mend sa kohë kishin që njiheshin dhe që s'ndaheshin nga njëri-tjetri e askushs'i kishte parë ata që t'i mbanin kokën mënjanë njëri-tjetrit. Natyrisht shoqëria e gjatë e tyre do të kishte pasur edhe ndonjë grindje, por mëri ama, kurrë. Grindja midis tyre nuk linte gjurmë. Ajo zhdukej më shpejt se sa shkëlqimi i një meteori natën në qiell.

«Dy gjëra e prishin shoqërinë, — kishte thënë njëherë Lal Likoja, — dy gjëra: makutëria dhe shkelja në dërrasë të kalbur. Makutëria pjell vese më shumë se buçja këlyshë. Të shkelësh në dërrasë të kalbur, i ke thënë armikut hajde të puthemi».

«Mirë e ka, — tha Ngjeli duke parë sahatin e xhepit, mbasi të dy bashkë do të shkonin në punë, — mirë e ka, — foli prerë ai — shoku dhe miku kanë nevojë për dashurinë që nxjerr zemra».

Atij iu kujtua ajo ditë, kur mori Medaljen e Punës. Të gjithë shokët ishin të mendimit që medaljen në gjoksin e Ngjeli Saros ta vendoste Lal Likoja. Ashtu u bë. Lal Likoja u rinua. Në ato pesë hapa që bëri derisa vajti te shoku, u pengua dy-tri herë. E kishin pushtuar emocione plakun. Dashuria për shokun e tij të vjetër lexohej në sy. Të dy pleqtë u përqaftuan. Ato dy koka të thinjura ndejtën për disa çaste pranë e pranë. Të gjithë sa qenë në sallë ishin çuar vetvetiu në këmbë. Ngjeli Saros i ishin njomur sytë. Kishte qarë.

— «Atë ditë qava, — kujtoi si me turp Ngjeli, — qava, — dhe psherëtiu disi i lehtësuar. — Në kohën e Luftës kisha në shtëpi një partizan nga Skrapari, kur e kapnin dhembjet e plagës diç këndonte, kur lehtësohej, merrte dhe i binte fyellit. Po ama një ditë sytë, tek këndonte fort, iu lëngëzuan. Po, po, më kujtohet. Po... ama ishte burrë, ishte trim. Bënte çudi, trimëri të rralla kur ishte në betejë. Më thoshin shokët e tij.»

Ngjeli vuri buzën në gaz. Vetulla e djathtë iu harkua dhe pastaj lëshoi një të qeshur të lehtë. «Po Lal Likoja ç'tha atë ditë?» Ai shtrëngoi shportën me qershi që mbannte në ije, me aq dashuri, sikur të shtrëngonte krahun e Lal Likos. «Qau Ngjeli Saroja, — kishte thënë ai para të gjithë punëtorëve, — qau dhe mirë bëri. Ju jeni të rinj, — kishte vazhduar Lal Likoja, — dikur mbi gjoksin tonë hidhnin pështymë dhe copa të mykura buke. «Plehraxhinj, na thoshin, leckamanë.» Për të tilla gjëra ishte gjoksi ynë sipas tyre. Por... — Lal Likoja kishte shtrënguar Ngjelin, — ...por, s'qenka ashtu. Nga Tirana i erdhi një copë diell Ngjeli Saros.» Dhe kishte ngritur medaljen lart,

pastaj duke dihatur thellë kishte shtuar: «Sot e mori miku dhe shoku im dhe tuaji. Nesër ne. Pse të mos e marrim? Tani, dielli i tërë është yni.»

Me këto kujtime Ngjeli Saroja e bëri rrugën deri te shtëpia e shokut të tij. Mbas pak të dy dolën në rrugë. U nisën për në punë. Ata ishin të dy karrocierë.

— Pimë një kafe, Lal Liko.

— Jemi vonë, e lemë...

— E lemë — pranoi Ngjeli.

Nxituan. Lal Likoja ishte i shkurtër. E ndonëse ishte krejt i zbardhur nuk të jepte për aq sa qe. Për këtë të gënjente trupi i drejtë, e ecura e shpejtë dhe e lehtë. Ndërsa Ngjeli Saroja ishte i gjatë. Sytë e vegjël si rruaza e plot shkëlqim e tregonin njeri të mirë dhe të ndieshëm.

— Ai, kuqoja im, — tha Ngjeli për kalin e tij — s'është mirë. Dje, gjithë pasditen i rrahën barqet, pa le, të lëshonte dhe një kollë që...

Ta dëgjonte njeri tjetër atë të folur që mbaroi me një psherëtimë të thellë, zor se do t'i shpëtonte mallëngjimit, sado i gurtë që të ishte. Lal Likoja ishte mësuar. Vuri buzën në gaz dhe tha:

— Po plaket kuqoja. I hodhi tej tri karroca.

— Tri besa! - u gjallërua Ngjeli Saroja.

Morën majtas dhe hynë në oborrin e ndërmarrjes. Nuk kishte lëvizje. Asnjë njeri nuk dukej. Tutje, rrëzë murit, karrocet rrinin të heshtura; ndërsa kuajt me turinj të zhytur në qeskat e zeza, hanin duke tundur bishtin. Lamja u bëri me shenjë nga salla e mbledhjeve. Ata panë në sy shoku-shokun dhe shpejtuan për në sallë. Kishte ardhur dhe drejtori. Mbledhja qe e rëndësishme.

— ... pra, le ta përfundojmë, — e ngriti zërin drejtori, — qyteti ynë po ndryshon nga dita në ditë. Zhvillimin e tij nuk mund ta ndjekë dot rrota e karrocës. Na kanë ardhur ca makina të vogla. Ju, jeni të rinj dhe të for-

të dhe mund t'i jepni atdheut më shumë në një front tjetër... Por, tani për tani, për të plotësuar ndonjë nevojë të vogël, unë mendoj të lëmë dy karrocierë dhe... — drejtori qeshi dhe përfshiu gjithë sallën me sy... — dhe meqenëse kam fjalën, po bëj dhe propozimin tim.

Salla gumëzhiu nga një e qeshur.

—... domethënë më lejuat, — vazhdoi ai. — Mirë, mendoj që të vazhdojnë punën si karrocierë Lal Likoja dhe Ngjeli Saroja, mbasi ata... — Drejtori nuk mundi të bëjë sqarimin. Në sallë shpërthyen duartrokitje. Punëtorët u çuan në këmbë. Dolën në oborr. Lal Likoja i hodhi krahun Ngjelit.

— Si tha? — pyeti ai për drejtorin, — si tha, zhvillimin e qytetit s'e ndjek më dot rrota e karrocës. Bukur.

— Bukur besa!

— Eu, mor Ngjeli Saro, eh! Shumë ndryshime po bëhen dhe më shumë do të bëhen. Diell do të bëhet Shqipëria, diell, — zëri i Lal Likos ishte i tronditur dhe emocional. Ai zë depërtoi drejt në zemrën e Ngjelit, i cili e shikoi shokun e tij me mall dhe me habi.

— Fat, — tha Ngjeli, — fat i madh për ne shqipëtarët që ta kalojmë jetën të bardhë.

— Fat i popullit, Ngjeli Saro, — tha Lal Likoja duke mos ia ndarë sytë portretit të madh të udhëheqësit tonë të vendosur në stendën e kuqe në hyrje të ndërmarrrjes. — Fat i tërë botës — përfundoi ai po me atë pamje lumturie në fytyrë.

## B A R A K A

Baraka, ku punoja unë dhe ustai im Sherifi, mbeti jashtë mureve të fabrikës. Dikur, në kohën e montimit, baraka jonë ishte një nga vendet më të rëndësishme të punës në kantier. Kushdo që ka punuar në montim ia di mirë vlerën kovaçanës pavarësisht se nga të dukurit, disa listela dërrase të mbuluara me eternit, s'ta mbushin syrin. Ndërsa tani që fabrika filloi të prodhojë, të ketë edhe kovaçanën e saj akull të re, merret me mend sa i vajti vlera barakës sonë.

— O buçko! — më thirri ustai. Kështu më thërriste ai. — Buçko, na ra vlera, mbetëm komplet jashtë.

Unë, që diçka po kërkoja, u dhashë te dera. Muratorët vendosën tullat e fundit mbi mur dhe u larguan. Më kapi një trishtim i lehtë dhe atë çast mendova se që nga ajo ditë s'kisha më punë brenda atyre mureve. Ustai sepse qeshi. Kjo s'i shkonte aspak gjendjes sime, prandaj do-  
la jashtë dhe u ula mbi disa hekura.

— U mërzite, o buçko. Mos u mërzit se është fetë e majme kjo, — vazhdoi ustai, duke qeshur e duke qëlluar ritmiksht mbi kudhër.

E vështrova me cepin e syrit. Dhëmbi i tij i metaltë, i mbetur pa të tjerë anash, m'u duk diçka e keqe, ndërsa

vetë ai m'u duk një njeri i rëndomtë, një njeri... Dhe për herë të parë pas dy vjetësh mora inat veten që kisha punuar me një njeri të atillë. Ç'është e vërteta s'kishim pasur ndonjë grindje dhe kishim kaluar mirë. Pastaj unë i isha borxhli atij. Ai më kishte mësuar zanatin. Më kishte dhënë shumë nga vullneti i tij. Po tani që mbetëm këtej murit, më shumë pa punë se sa me punë, ç'e kishte atë gëzim? Ç'na qenka «kjo fetë e majme»! Mos vallë iu ringjall ndërgjegjja e zejtarit. Ndoshta baraka e veçuar i ngjalli atij ndjesinë e dyqanit të tij të dikurshëm, kur ai ende nuk ishte hedhur në armatën e madhe të punës. Ndoshta!...

Mendova të shkoja tek inxhinieri. Po unë, para dy ditësh e kisha takuar. «Dëgjo, — më kishte thënë ai, — pse shqetësohesh kaq shumë, edhe ti me usta Sherifin për-kohësisht: do të qëndroni aty. Gjysmën tjetër të muajit kovaçana e re do të jetë stabilizuar përfundimisht».

Edhe një javë e mbyllej tërë muaji, ndërsa për ne asgjë s'po bëhej. Vinim në mëngjes me urbanin e linjës. Punëtorët e tjerë hynin në portën e madhe të fabrikës, ndërsa unë me ustanë i binim rreth e rreth mureve, derisa mbërrinim në barakën tonë. «Ç'do të bëjmë sot?» Po bëre këtë pyetje pa futur këmbë në punishte, mendo se ç'punë do të bësh për tetë orë. Me sa kuptohej, këtë pyetje e bëja vetëm unë, ndërsa usta Sherifi... Ai vinte mbi farkë, kokë më kokë, tre thëngjij...

— Fryji pak, o buçko.

E, kur kuqej zjarri, vinte rreth tij dy fetë bukë dhe një kanaçe ku fuste dy vezë për të zier.

— Edhe sot avazin? — i thashë kur hyra brenda.

— E di komanda atë punë.

Kjo do të thoshte e di drejtoria.

— Usta Sherif...

Ai e kuptoi ç'do t'i thosha unë dhe më ndërpreu:



— Pse mërzitesh? Kur ka pasur punë mos kemi për-  
tuar? Kush i ka rrahur gjithë ato hekurat... Ë... Pa më  
thuj?

Unë s'fola. Që ai s'ia përtonte punës këtë e dija mirë.  
Moshën s'e kishte sa timen, e natyrisht, as shëndetin. Unë  
i kisha shpatullat dy herë më të gjera se ai, por ama va-  
reja në dorën e tij fluturonte dhe jo rrallëherë, kur mua  
më pikonte djersa pika-pika mbi metal, ai ma merrte va-  
renë e me të qeshur më thoshte: «Më mirë të dish se sa të  
kesh. Ti ke forcën, o buçko, po ustai ka ustallëkun».

Kur solla ndër mend këto, s'm'u ndejt pa i thënë:

— Shkojmë në drejtori dhe u themi se...

— Mos u rrëmbe, — më ndërpreu ai, — i dinë vetë ata  
këto punë. Po hajde, hajde, — dhe nxori nga farka një  
fije balestre flakë të kuqe. Mora varenë e fillova të godas  
mbi të me një forcë që s'ishte e nevojshme për të rrahur  
atë pllakë trecentimshe. Ustai më hodhi një shikim qortu-  
es dhe unë rregullova dorën.

Afër drekës erdhi inxhinieri.

— Shpëtuam! — thashë unë, duke fërkuar duart.

Inxhinieri, pasi na përshëndeti, i dha një letër usta  
Sherifit.

— Të kam prurë skicën për disa bulona bazamenti.  
Në fund të javës do të montojmë pneumatikun e madh dhe  
atëherë... — Ai qeshi.

— Si? — bëra unë. — Edhe këtë javë këtu do ta mby-  
lлим ne?

— Për të paguar ju kemi paguar, — tha i qeshur ai dhe  
shtoi, — pastaj pushoni pak se ç'është e vërteta u lodhët.

— S'është fjala te pagesa, — iu përgjigja unë. — Si-  
kur edhe dyqind copë bulona të duhen ne i bëjmë për dy  
ditë. Po ditët e tjera?

Ai qeshi me zë dhe tha:

— Epo, unë s'ju mbaj mbi kurriz. Bëni si të bëni. Ditën e hënë do të vini edhe ju te shokët e tjerë.

— Qofshin ditët e fundit!, — thashë unë i pezmatuar. Inxhinieri më tërhoqi pas vetes.

— Ja, zëre se erdhi dhe fundi i javës!

Ustai që deri atëherë s'e kishte hapur gojën, tani lëvizi buzët dhe e përcolli inxhinierin deri te dera. Kur u kthye më hodhi sytë vëngër e më tha:

— Dëshirë për punë të kesh!

Futi pllakën e skuqur në kazanin e ftohjes dhe do-  
li jashtë. U nxe! Se mos jam unë fajtor, e qetësova veten.  
Vendosa të punoja vetë. Mora shufra hekuri me dimensio-  
nin e bulonave që na porositi inxhinieri dhe i futa në zjarr.  
Prapa arkës ku ne mbanim hekurishte të ndryshme pashë  
tri copë sëpata dhe dy sqeparë të punuar për merak dhe të  
mprehtë si brisq rroje. Ç'donin ato aty! Mos vallë ishin po-  
rosi nga ndonjë repart i fabrikës? Pak më tutje pashë  
gjashtë çifte patkojsh. Po këto! Fabrika patkonj? Ish-  
te qesharake të mendoja më gjatë. Ç'bën ustai me këto?!  
Mos: . . . Mua më vinte keq të mendoja se ai mund t'i shiste.

Matanë dritares vura re ustanë që po bisedonte me  
një burrë zijosh. Zijoshi mbante veshur një mushama kafe  
të rrjepur te supet. E kisha parë edhe nja dy herë të tje-  
ra atë. Bile, njëherë, kur unë e pyeta ç'e donte usta Sheri-  
fin mbasi ustai nuk ishte në kovaçanë ai sepse qeshi e  
më tha: «Jo, mor jo, s'kisha gjë, jemi të një dore e s'bën  
të harrohemi». Dhe fërkoj lëkurën e zeshkët të fytyrës...

Tani zijoshi i la një shportë ustait dhe iku. Unë vet-  
vetiu vështrova ato që ishin fshehur prapa arkës. «Diçka  
ka midis atyre dhe zijoshit, — thashë:

Ustai më thirri. Dola jashtë dhe vajta pranë tij. Më  
bëri shenjë dhe mua që të ulesha.

— Hamë nga një kokërr fik, — tha ai me buzë në gaz  
dhe sakaq e ktheu shportën mbi bar.